


REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE PRIZREN/ OSNOVNI SUD U PRIZRENU/ BASIC COURT IN PRIZREN

Nr.475-05/2012

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN – Divizioni për Kundërvajtje, me gjyqtarin **Gjimshit Galushi**, dhe procesmbajtësen **Nexhla Vebiqi** në procedurën kundërvajtëse kundër të pandehurit **Lulzim Kabashi nga Prizreni**, për shkak të kundërvajtjes nga neni 5. dhe 6. par.1.3 .si dhe neni 9 , të ndëshkuar sipas neni 17.par.1.3 të Ligjit për Deklarim, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe Dhuratave të Zyrtarëve të Lartë Publik , e në bazë të neni 195 të LMK-së, me datën 16.10.2013 merr këtë :

A K T V E N D I M

I pandehuri Lulzim Hisen Kabashi , i lindur me 15.02.1971, në fsh.Korish KK Prizren, me vendbanim në Prizren, rruga Kuvendi i Arbërit nr.11

Ë s h t ë P ë r g j e g j ë s

Sepse, sipas kërkesës së Agjensionit , e si Zyrtarë i lartë publik – deputet në asamble komunale në Prizren , nuk e ka bërë deklarinimin e pasurisë dhe prejardhjen e saj , pranë Agjensisë kundër Korrupsionit - brenda afatit Ligjor (deri më 31.03.2012), edhe pse ka qenë i obliguar ,

- me këtë veprim ka kryer kundërvajtjen nga neni 5. dhe 6.par.1.3 të ndëshkuar sipas neni 17.par.1.3 të Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe Dhuratave të Zyrtarëve të Lartë Publik , e për këtë , duke aplikuar nenin 9 të LMK-së ,

D Ë N O H E T

Me gjobë në lartësi prej 350 (treqind e pesëdhjetë)Euro .

I pandehuri obligohet që denimin e shqiptuar me gjobë , ta paguajë në afat prej 15 ditëve , nga dita e plotëfuqishmerisë së këtij aktvendimi . Poqese këtë nuk e bën në afatin e caktuar , atëherë gjoba e shqiptuar do të zavendosihet me burgim , duke llogaritur **20 euro për një ditë burgu** , kurse në afatin e njëjtë në emër të shpenzimeve gjyqësore, do të paguajë shumën prej **5 (pesë) euro**, nën kërcnim të ekzekutimit të dhunshëm .

Sipas kërkesës së Agjensisë kundër Korrupsionit të Republikës së Kosovës - në Prishtinë , me nr.01-1890-/2012 të datës **24.05.2012** , u zhvillua procedura kundërvajtëse kundër të pandehurit **Lulzim Kabashi nga Prizreni** , për shkak të kundërvajtjes nga neni 5. dhe 6.par.1.3 të ndëshkuar sipas nenit 17.par.1.3 të Ligjit për Deklarimin , Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe Dhuratave të Zyrtarëve të Lartë Publik .

Gjendja faktike është vërtetuar në bazë të provave të cilat gjinden në shkresat e lëndës , si dhe deklaratës të të pandehurit , i cili në deklaratën e tij ka theksuar se është e vërtet që deklarin e ka bërë pak me vonesë , pasi që edhe njoftimin - formularin për deklarin e pasurisë e ka marrur me vonesë , të cilën pastaj e ka plotësuar me datën **20.07.2012** , dhe e ka dërguar formularin mbi deklarin e pasurisë në Agjension kundër korrupsionit të Republikës së Kosovës , i cili edhe është pranuar me **24.07.2012**.

Nga të dhënat e parashtruar në kërkesë , vlerësimi të deklaratës së të pandehurit , si dhe vlerësimi të të gjitha provave së bashku , dhe secilës veç e veç të bashkangjitura në kërkesë , Gjykata konstatoi se me datën **20.07.2012** i pandehuri me të vërtet kishte plotsuar , por edhe ka dërguar formularin mbi deklarin e pasurisë në Agjensinë kundër korrupsionit , i cili ishte pranuar me **24.07.2012** , edhe pse pas afatit për dorzim .

Duke pasur parasysh rethanat nga neni 7 të LMK-së , se i njeiti ka patur sjelljet korekte , e poashtu faktin se me vonesë është njoftuar me formularin mbi deklarin e pasurisë , se nga afati ligjorë për deklarin e pasurisë kanë kaluar disa muaj , mirpo egziston fakti se i pandehuri në fjalë edhe pse me vonesë , i ka përmbush obligimin e vet , gjykata është qëndrim se në veprimet e të pandehurit egzistojnë elementet e veprës së kundërvajtjes nga dispozitat e shenuara më lartë , e duke aplikuar nenin 9 të LMK-së , e ka zbutur denimin , duke patur parasysh sjelljen e tij korekte , se deklarin me vonesë ka bërë nga mos njoftimi me kohë nga ana e organit kompetent , me bindje se edhe me këtë llojë të denimit do të arihet qëllimi i ndëshkimit , që i njeiti në të ardhmen të mos kryej kundërvajtje të tillë apo të ngjajshme , dhe të respektoj afatin ligjorë .

Vendimi mbi shpenzimet gjyqsore është marrë konform nenit 109.2 të LMK-së .

Me sa u cek me lartë , u vendos si në dispozitiv të aktvendimit .

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN - Divizioni për Kundërvajtje
Nr.475-05/2012, datë: 16.10.2013

Gjyqtari
Gjimshir Galushi

UDHËZIMI JURIDIK : Kundër këtij aktvendimi , pala e pakënaqur , mund të ushtrojë ankesë , Gjykatës së Apelit - Divizionit për Kundërvajtje në Prishtinë , në afat prej 8 ditëve , pas marrjes të të njejt , përmes kësaj Gjykate .